

Policy brief

# PAGA MESATARE DHE **SHPORTA MINIMALE KONSUMATORE**



Tetor, 2023

# ÇKA ËSHTE SHPORTA MINIMALE KONSUMATORE?

Shporta Minimale Konsumatore është kalkulimi i kostos së jetesës për një familje që supozohet të jetë 4 antarëshe, që jeton në shtëpi 50 m<sup>2</sup> dhe që nuk posedon veturë. Shporta konsumatore përfshinë produkte sipas kategorive në vijim:

- Ushqim dhe pije
- Strehim
- Higjienë
- Transporti
- Veshmbathje
- Mirëmbajtje dhe shëndet.
- Kulturë

Shporta konsumatore llogaritet nga Bashkësia e Sindikatave të Maqedonisë nga viti 2011 dhe publikohet për çdo muaj.

## ÇKA ËSHTE PAGA MESATARE?

Paga mesatare përfaqëson të ardhurat totale të fituara nga individët në vend pjesëtuar me numrin total të individëve që marrin këto të ardhura. Paga mesatare shërben si tregues kyç i të ardhurave tipike të fuqisë punëtore në Maqedoninë e Veriut.

Siç mund të shihet nga të dhënat, edhe pse paga mesatare ka shënuar rritje prej 14.06% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, **dallimi në mes të pagës mesatare dhe shportës konsumatore është rritur për 3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2022**, dhe 9 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021. Pra, edhe pse një familje që jeton me një pagë mesatare mund të marrë në total më shumë të holla, ajo mund të blejë më pak produkte nga shporta konsumatore krahasuar me 4 vitet paraqra.




Figura 1

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

## Paga mesatare si % e shportës minimale konsumatore, 2023




Figura 2

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

## PAGAT MESATARE SIPAS SEKTORËVE KRAHASUAR ME PAGËN MESATARE DHE SHPORTËN KONSUMATORE

Figurat 3 dhe 4 paraqesin sektorët të cilët kanë paga mesatare më të larta dhe më të ulta krahasuar me pagën mesatare nacionale. Nga gjithsej 19 sektorë të evidentuar nga Enti Shtetëror për Statistika, 10 sektorë kanë pagë më të ulët mesatare sesa paga mesatare nacionale prej 36,286 denarëve, ndërsa 9 sektorë kanë pagë më të lartë.

### Sektorët me paga më të ulta se mesatarja, 2023




Figura 3

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika




Figura 4

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

Nëse futemi në analizë më të thellë, shohim që nga gjithsej 83 sub-sektorë, vetëm 10 sosh kan paga mesatare më të larta shporta minimale konsumatore, ndërsa 73 sub-sektorë kanë paga më të ulta mesatare sesa shporta minimale konsumatore. Figurat 5 dhe 6 tregojnë 10 sub-sektorët me pagat më të ulta dhe ato më të larta krahasuar me mesataren.




Figura 5

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

Siç mund të shihet nga të dhënat, edhe pse paga mesatare ka shënuar rritje prej 14.06% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, dallimi në mes të pagës mesatare dhe shportës konsumatore është rritur për 3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2022, dhe 9 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021. Pra, edhe pse një familje që jeton me pagë mesatare mund të marrë në total më shumë të holla, ajo mund të blejë më pak produkte nga shporta konsumatore krahasuar me 4 vitet paraqake.






Figura 6

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

## SA ËSHTË NUMRI I PUNTORËVE NË INDUSTRI TË PËRKATËSE ?

Në raport me numrin e të punësuarve, statistikat tregojnë që **94% e të punësuarve (apo 647,210 puntorë) punojnë në industritë që marrin paga mesatare më të ulta sesa shporta minimale konsumatore** prej 48,620 denarëve, ndërsa vetëm 6% e të punësuarve (apo 41,242 puntorë) punojnë në industritë që kanë paga mesatare më të larta sesa shporta minimale konsumatore.

Në raport me pagën mesatare nacionale, statistikat tregojnë që 66% e të punësuarve (apo 454,213 puntorë) punojnë në industritë që marrin paga mesatare më të ulta sesa paga mesatare nacionale, ndërsa 94% e të punësuarve (apo 234,239 puntorë) punojnë në industritë që kanë paga mesatare më të ulta sesa shporta minimale konsumatore.




Figura 7

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

## Numri i të punësuarve në industritë me paga mesatare mbi dhe nën pagën mesatare nacionale, 2023

● Me paga mbi pagën mesatare ● Me paga nën pagën mesatare




Figura 8

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

## NIVELI I VARFËRISË NË TRE VITET E FUNDIT

Të dhënat tregojnë që niveli i varfërisë në Maqedoninë e Veriut mbetet relativisht konstat në periudhën e fundit. Të dhënat e fundit të qasshme tek Enti Shtetëror për Statistika tregojnë që në Maqedoninë e Veriut 451,900 persona jetojnë nën pragun e varfërisë, një rritje prej 0.85% krahasuar me vitin 2019.

### Numri i personave që jetojnë nën pragun e varfërisë, 2018-2020




Figura 9

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

## PËRFUNDIM

Paga mesatare në dy vitet e fundit ka shënuar rritjen më të madhe në 11 vitet e fundit, pra në vitin 2022 ajo u rrit për 11.46% ndërsa në vitin 2023 për 14.06%. Megjithatë, në anën tjetër shporta minimale konsumatore ka shënuar gjithashtu rritjen më të madhe në 11 vitet e fundit, edhe atë me 18.83% në vitin 2022 dhe 19.89% në vitin 2023. Prandaj, si pasojë e kësaj rritje eksponenciale të shportës minimale konsumatore, në dy vitet është zgjeruar distanca në mes të pagës mesatare dhe asaj konsumatore duke i lënë familjet me më pak të holla për ta mbuluar shportën minimale konsumatore.

Një fakt interesat i parashtuar në këtë brief është numri total i personave që punojnë në sektorët dhe sub-sektorët të cilët kanë paga mesatare më të ulta sesa paga mesatare dhe shporta minimale konsumatore. Edhe përkundër rritjes së pagës minimale dhe asaj mesatare, e pamë që mbi 96% e të punësuarve bien në sub-sektorët të cilët kanë paga mesatare më të ulta sesa shporta minimale konsumatore.

Ajo që bie në sy është po ashtu distanca shumë e vogël në mes të pagave mesatare të sub-sektorëve të cilët tejkalojnë shportën minimale konsumatore me shportën minimale konsumatore, dhe distanca e madhe e pagave mesatare të sektorëve të cilët kanë paga mesatare më të ulta sesa shporta minimale konsumatore me shportën minimale konsumatore, një indikatorë i gjendjes së rëndë financiare të të punësuarve të cilët mund të jenë në prag të varfërisë.

Sa i përket nivelit të varfërisë, duket që ai ka mbetur konstant gjatë kësaj periudhe, me pothuajse 1/3-tën e popullsisë - apo gjithsej 451,900 - nën pragun e varfërisë në vitin 2020.

Instituti IDEA rekomandon kujdes në interpretimin e rritjes së pagës mesatare si tregues i rritjes së mirëqenies së qytetarëve të punësuar, meqë dukshëm standardi i jetesës ka pësuar rritje disproporcionale në raport me pagën mesatare.

Për fund, më shumë hulumtime duhet të bëhen mbi distribuimin e pagave në sub-sektorët përkatës për të parë shpërndarjen e pagave në mënyrë edhe më të detajuar dhe për të mundësuar vlerësim të mirëfilltë të gjendjes së pagave në raport me pagën mesatare dhe shportën konsumatore.



Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike – IDEA është “think tank” i krijuar në mars të vitit 2023 në Shkup, me mbështetjen e European Endowment for Democracy.

Në esencë, ne besojmë se forca e demokracisë tonë dhe cilësia e politikave ekonomike janë ngushtë të lidhura me angazhimin dhe pjesëmarrjen tonë demokratike. Ky besim i palëkundur ushqen qëllimin tonë, si ekip i përkushtuar për të kontribuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të demokracisë dhe politikave ekonomike në Maqedoninë e Veriut.

Ne e përfytyrojmë Maqedoninë e Veriut si një shtet anëtar progresiv, liberal dhe rezilient i Bashkimit Evropian i cili është i ndërtuar mbi gjithëpërfshirje, inovacion dhe qëndrueshmëri. Ne jemi këtu për ta avancuar demokracinë dhe për të nxitur zhvillimin!

[www.idea.org.mk](http://www.idea.org.mk)

Tetovska 33/2/7 , Skopje, Republic of Macedonia

+389 70 985 729